



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 001/30

Datë: 30.11.2010

Ne bazë të neneve 12.2 /d/ dhe 17 /b/ të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040); dhe nenit 10 pika /b/ të Statutit të Komunës së Junikut. Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2010, merr këtë:

V E N D I M
për fillimin e hartimit të
PLANIT RREGULLUES URBAN
NJËSIA “GACAFER dhe PEP SH”

I. Me këtë Vendim fillohet Hartimi i **Planit Rregullues Urban (PRRU)** NJËSIA “GACAFER dhe PEP SH”, /në tekstin e mëtejme : **Plani/**.

II. Në këtë **Vendim** përfshihet Lokacioni: Pjesërisht lagjet **GACAFER** dhe **PEP SH** me sipërfaqe të përafërt prej **S= 28 Ha** respektivisht, Ngastrat Kadastrale me Nr: **1129, 1131 deri 1137, 1147 deri 1152, 1158 deri 1163, 1437 deri 1468, 1470 deri 1547, 1550 deri 1561, 1591, 1594 deri 1631, 1634 deri 1645, 1648, 5089, 5101, 1457/1, 1457/2, 1457/3, 1469/1, 1469/2, 1469/3, 1613/1, 1613/2, 1633/1 dhe 1633/2;** Zona Kadastrale Junik.

III. Me Planin nga Pika I e këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Junikut.

IV. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të këtij Plani, sipas këtij Vendimi, është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, harmonizimi i drejtpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të regjimit të planifikimit hapësinor dhe urban në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe arritjen e caqeve afatgjata të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Komunës së Junikut.

V. Ky **Plan** është pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban dhe duhet të shërbejë si bazë për ndërtim.

VI. Bartës i hartimit të **Planit** sipas Pikës I të këtij Vendimi është Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.

VII. Bartësi i hartimit të Planit sipas Pikës I të këtij Vendimi është i obliguar që Planin ta hartojë në afat kohor prej gjashtë /6/ muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

VIII. Projekt Plani duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e Planit në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në mjetet e informimit.

IX. Mjetet Financiare për hartimin e Planit sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut në bazë të Kontratës Nr. 39 të datës 01.11.2009 të lidhur në mes të Komunës së Junikut dhe N.SH. “**A design**”.

X. Plani hartohet për periudhën kohore më së paku pesë / 5 / vjeçare.

XI. Elaborati i Planit sipas Pikës I të këtij Vendimi duhet të hartohet në shtatë /7/ kopje (të origjinalit) fizike dhe /1/ elektronike.

XII. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me këtë vendim njoftohet:

- Drejtoria e për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis,
- Arkiva e Komunës Junik.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Sinan Gacaferi